

SHOQËRIA TREGTARE
"INA - 96" SHPK
SKRAPAR



VENDIM NR. 02 datë 15.11. 2006
I ORTAKUT TË VETËM
TË SHOQËRISË TREGTARE
"INA - 96" SHPK

Në Tiranë, sot në datën 15, muaji Nentor, 2006, u mbledh Ortaku i Vetëm i Shoqërisë Tregtare "INA - 96" SHPK, në selinë e shoqërisë, për shqyrtimin e rendit të ditës:

- Shqyrtimi i Raportit të Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Fitimeve të pashpërndara dhe rezervave për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 30 Tetor 2006 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabël i Autorizuar;

Ortaku i Vetëm i Shoqërisë, znj. Brunilda GJINECI, pasi u njoh me rendin e ditës;

V Ë R E N S E

Shoqëria Tregtare "INA - 96" SHPK, është regjistruar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 13304 datë 12. 01. 1996 të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë.

Ortak i Vetëm i kësaj shoqërie është znj. Brunilda GJINECI. Kapitali themeltar i nënshkruar i kësaj shoqërie është 100 000 (njëqind mijë) Lekë. Kështu, znj. Brunilda GJINECI, zotëron 100 % të kapitalit themeltar të nënshkruar, i barabartë ky me 100 (njëqind) kuota me vlerën 100 000 (njëqind mijë) Lekë, ku secila kuotë ka vlerën prej 1 000 (një mijë) Lekë;

Me Vendimin Nr. 01 datë 15. 06. 2005, Ortaku i Vetëm i Shoqërisë ka vendosur:

1. Te miratoje llogarite vjetore te shoqerise per vitin financiar 2005 (01 Janar 2005 deri me 31 Dhjetor 2005);
2. Te zmadhoje kapitalin themeltar të nënshkruar të shoqërisë nepermjet fitimeve të pashpërndara dhe rezervave te materializuara ne kontribute ne natyre, gjendje te dates 31 Dhjetor 2005;
3. Caktimin e z. Lavdimir FUSHA, si Ekspert Kontabël te Autorizuar, me Nr. Liçence 97, datë 10 .01. 2001, leshuar nga Instituti i Eksperteve Kontabel te Autorizuar, për te hartuar raportin, per zmadhimin e kapitalit te shoqerise "INA - 96" sh.p.k nepermjet fitimeve të pashpërndara dhe rezervave te materializuara ne kontribute ne natyre, gjendje deri me date 31 Dhjetor 2005;
4. Depozitimin e këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor TIRANË.

Ky vendim është depozituar pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar me Vendimin Nr. 13304/1 datë 24. 10. 2006 të Gjykatës së Rrethit Gjyqesor Tiranë.

Në vështrim të rendit të ditës, Ortaku i Vetëm i kësaj shoqërie, pasi njihet me Raportin e Ekspertit Kontabël të Autorizuar për Vlerësimin e Fitimeve të Pashpërndara për Zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë, të datës 30. 10. 2006, i përgatitur nga Eksperti Kontabël i Autorizuar z. Lavdimir FUSHA, vëren se ky raport është i drejtë, në përputhje me ligjet në fuqi dhe për këto arsye duhet miratuar.

SHOQËRIA TREGTARE
"INA - 96" SHPK
SKRAPAR



Sipas këtij raporti, zmadhimi i kapitalit themeltar të shoqërisë bëhet nga 100 000 (Njëqind mijë) Lekë në 11 200 000 (Njembdhjet milion e dyqind mijë) Lekë, e barabartë kjo me 100 (Njëqind) kuota (pjesë) kapitali, secila me vlerë nominale prej 112 000 (njëqind e dymbdhjet mijë) Lekë. Pra, numri i kuotave (pjesëve) të kapitalit themeltar të nënshkruar mbetet i pandryshueshëm dhe vetëm vlera nominale e tyre rritet.

Ky kapital do të zotërohet nga Ortaku i Vetëm në këtë mënyrë:

Znj. Brunilda GJINECI, do të jetë përsëri zotërues i 100 % të kuotave të kapitalit themeltar, i cili do të përbëhet nga 100 (njëqind) kuota (pjesë) kapitali nga ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 112 000 (njëqind e dymbdhjet mijë) Lekë.

Për këto arsye, Ortaku i Vetëm, pas shqyrtimit të rendit të ditës;

V E N D O S I

1. Miratimin e Raportit të Ekspertit për vlerësimin e Rezervave dhe Fitimeve të pashperndara për zmadhimin e Kapitalit Themeltar të Shoqërisë të datës 30 Tetor 2006 të përgatitur nga z. Lavdimir FUSHA, Ekspert Kontabel i Autorizuar;
2. Zmadhimi i Kapitalit Themeltar të nënshkruar të kësaj shoqërie nga 100 000 (Njëqind mijë) Leke në 11 200 000 (Njembdhjet milion e dyqind mijë) Leke, e barabartë kjo me 100 (Njëqind) kuota (pjesë) kapitali ;
3. Numeri i kuotave (pjesëve) të kapitalit, mbetet i pandryshueshëm, dhe rritet vetëm vlera nominale e tyre;
4. Vlera e çdo kuote (pjesë) kapitali kalon nga 1 000 (Një mijë) Leke në 112 000 (Njëqind e dymbdhjet mijë) Leke;
5. Znj. Brunilda GJINECI, do të jetë përsëri zotëruese e 100 % të kuotave të kapitalit themeltar, i cili do të përbëhet nga 100 (Njëqind) kuota (pjesë) kapitali ku secila kuotë (pjesë) do të ketë vlerën nominale prej 112 000 (Njëqind e dymbdhjet mijë) Leke;
6. Depozitimin e këtij vendimi pranë Zyrës së Regjistrimit Tregtar të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

ORTAKU I VETËM
I SHOQËRISË TREGTARE
"INA - 96" SHPK

Znj. Brunilda GJINECI